

VENDIM
Nr.522, datë 26.7.2006

**PËR TRANSFERIMIN E SIPËRFAQES 91 M², KOMPONENTE E PRONËS NR.1095
“DEGA E MOBILIZIM-REKRUTIMIT”, KUÇOVË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË
PRONËSI TË BASHKISË SË QYTETIT KUÇOVË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR.515, DATE 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të sipërfaqes 91 m² komponente e pronës me numër rendor 1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, nga Ministria e Mbrojtjes, në pronësi të bashkisë së Kuçovës, në kuadër të zbatimit të projektit CARDS, të financuar nga Banka Botërore, për rikonstruksionin e rrugës “Naftëtari 3.1.1”.

2. Nga prona nr.1095 “Dega e mobilizim-rekrutimit”, Kuçovë, të hiqet sipërfaqja 91 m² nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.

3. Bashkisë së qytetit Kuçovë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Kuçovës dhe kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha